



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:208262
Datë: 13.01.2025
Numri i dokumentit: 06702653

Rev.nr.573/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, kryetar, Nenad Llaziq dhe Rustem Thaqi, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A. Zh. nga P., rruga "...", nr., hyrja., nr..., të cilin në bazë të autorizimit e përfaqëson Armend Krasniqi, avokat nga P., kundër të paditurës "K. N.", me seli në P., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson T. H., për kompensim dëmi material, duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurës, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3324/21, të datës 19.06.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 13.01.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës "K. N.", me seli në P., kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr. 3324/21, të datës 19.06.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.2109/009, të datës 06.02.2021, ka vendosur si vijon: "I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A. Zh. nga P., rruga "...", nr..., hyrja..., nr., ashtu që DETYROHET e paditura "K. N.", me seli në P., që paditësit, në emër të kompensimit të dëmit material për shkak të djegies së banesës me datë 31.05.2009, si pasojë e shkaktimit të zjarrit nga resiveri i të paditurës t'i paguaj, në emër të dëmit për riparimet e mureve, dritareve dhe dyshemesë, shumën prej 4,600.00 €, në emër të dëmit për orenditë, pajisjet shtëpiake

dhe veshmbathje, shumë prej 9,000.00 €, të gjitha me kamatë, në lartësi të cilën e paguajnë bankat vendore për një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga datë 06.02.2021, e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm. II. DETYROHEN të paditurat që paditësi t'i paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 1,960.00 €, në afat prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit e nën kërcenim të përmbarimit me dhunë".

Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin Ac.nr. 3324/21, të datës 19.06.2024, ka refuzuar si të pa bazuara ankesën e të paditurës "K. N.", me seli në P., ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2109/2009, të datës 06.02.2021.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë e paditura, përmes të autorizuarit avokat Taulant Hajdar, nga Shoqëria e avokatëve Sejdiu&Qerkini në P., ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të pranoj revizionin, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe ai Gjykatës se Apelit të ndryshohet, ashtu që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet si bazuar në shumat e kërkuara në kërkesëpadi.

Paditësi nuk ka paraqitur përgjigje në revizionin e të paditurës.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 215, gjeti se:

Revizioni i të paditurës është i pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezultojnë se paditësi, me datën 16.09.2009, pranë gjykatës së shkallës së parë ka paraqitur padi, kundër të paditurës, për shkak të kompensimit të demit, me arsye sikurse në padi. Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse si dhe të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur si në dispozitivin e të njëjtit. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se në bazë të raportit të aksidentit me numër i dt.01.06.2009, ka konstatuar se me datë 31.05.2009, rreth orës 17:10, në banesën e paditësit kishte shpërthyer zjarr dhe dyshohet se është shkaktuar vepra penale shkaktimi rrezikut të përgjithshëm dhe sipas deklaratës së paditësit rezultojnë se i është djegur e tërë dhoma e pritjes dhe se tymi i zjarrit kishte kapluar tërë dhomat e që të gjitha duhet të riparohen ku ka theksuar se në vend ngjarje kishte qenë edhe eksperti komunal i zjarrit i cili në raportin e tij kishte cituar se "zjarri kishte shpërthyer si pasojë e ndezjes së resiverit" të marrë nga Kompania "K." e pastaj janë djegur pjesët tjera të banesës dhe sipas vërtetimit të lëshuar nga Komuna

e Prishtinës i dt.04.06.2009 RR - evidentues - ..., ka konstatuar se Inspeksioni i Preventivës për Shpërthimin e Zjarrit më datë 31.05.2009, rreth orës 17:00, kishte vërtetuar se në banesën e paditësit, në dhomën e ndejës kishte ndodhur një shpërthim zjarri, ku nga zjarri ishin djegur dhe dëmtuar këto pjesë: TV me resiver të kompanisë "K.", komode, dritaret dhe inventari i brendshëm në dhomën e pritjes tavani me mure në tërësi dhe dyshemeja, e tërë kjo kishte ardhur si pasojë e resiverit dhe se dëmet ishin të konsiderueshme.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit po ashtu ka theksuar se nga raporti i hulumtimit të zjarrit lëshuar nga Komuna e Prishtinës me numër ... i dt.01.06.2009, ka konstatuar se Komuna e Prishtinës me raportin e hulumtimit të zjarrit të datës 31.05.2009 është njoftuar nga Qendra e Informimit dhe Alarmimit se në adresën e paditësit kishte rënë zjarr dhe se ishte duke u djegur një banesë dhe se zjarri kishte shpërthyer si pasojë e ndezjes së reseverit të marrë nga kompania "K." tani e paditura në këtë procedurë dhe se zjarri ishte spontan dhe se nuk kishte dyshime për zjarr të qëllimshëm. Nga ekspertiza teknike e punuar nga eksperti i elektros Y. Z. i caktuar me aktvendimin datës 18.10.2017 dhe ekspertiza e ekspertit Xh. S., e paraqitur në gjykatë në nëntor të vitit 2018 rezulton se shkaktari i zjarrit është resiveri, si pasojë e mos barazimit të potencialit elektrik mes rrjetit kabllor dhe pajisjeve tek klienti, ndersa lartësia e kërkesëpadisë është vërtetuar nga ekspertiza financiare e punuar nga R. B., rrjedh se vlera e dëmeve të shkaktuara nga zjarri, është në shumë: dëmi material-riparimet e mureve, dritaret, dyshemeja etj, në shumë prej 4,600.00 €, ndërsa dëmi-orenditë dhe pajisjet shtëpiake plus veshmbathja, është në shumë prej 9,000.00 €, gjithsejtë vlera e dëmit sipas ekspertizës është 13,600.00€, të cilave ekspertizave ja ka falur besimin e plotë. Mbi arsyet e lartcekura, gjykata e shkallës së parë, vendosi si në dispozitivin e aktgjykimit duke u bazuar në nenin 154, 158, 172, 173 dhe 174 të LMD-së, ndërsa lidhur shpenzimet procedurale ka vendosur duke u bazuar në nenin 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e as në shkeljet e pretenduara me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit aktgjykimi i ankimuar del se nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit po ashtu janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë.

Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Gjykata e Apelit nuk i kishte pranuar pretendimet e ankuesit për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë sepse me provat e administruara u vërtetua në mënyrë bindëse se e paditura mban përgjegjësi për faktin se dëmi i shkaktuar qëndron në lidhje kauzale me veprimtarinë e të paditurës, dhe se dëmi është shkaktuar ekskluzivisht si pasojë e zjarrit të shkaktuar nga resiveri e cila pajisje është në pronësi të paditurës, e cila gjendje faktike është vërtetuar bindshëm me ekspertizat e elektros të punuar nga ekspertet Y. Z. dhe Xh. S., ndërsa lartësia e kërkesëpadisë është vërtetuar drejt me ekspertizën financiare të punuar nga eksperti R. B. si dhe në këtë drejtim e paditura nuk ka paraqitur pretendim ankimor përkitazi me lartësinë e dëmit dhe si rrjedhojë gjykata e shkallës së parë me të drejtë ia ka falur besimin ekspertizave gjyqësore, me arsyetim se përmbajnë elementet e nevojshme të dhënë mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsyeve të mjaftueshme të cilat kjo gjykatë i vlerëson si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Ka shtuar se e paditura gjatë shqyrtimit kryesor, me asnjë provë materiale nuk ka arritur të vërteton të kundërtën e asaj që e kanë konstatuar ekspertet gjyqësor. Në këtë situatë juridike ligjvënësi ka paraparë në nenin 319.1 të LPK-së, si vijon: Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta, ndërsa neni 322.3 ka paraparë: Pala e cila e konteston ekzistimin e ndonjë të drejte e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar krijimin apo realizimin e saj, ose në bazë të të cilit ka pushuar se ekzistuari, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër. Nga një gjendje e tillë faktike e konstatuar dhe vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, i pathemeltë qëndron pretendimi ankimor i palës ankuese edhe sa i përket zbatimit të gabuar të ligjit material, pasi që për tu plotësuar kushti ligjor i paraparë me nenin 154 të LMD-së, me të cilën dispozitë shprehimisht përcaktohet: Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij, domosdoshmërisht duhen të plotësohen këto parakushte: Të ekzistojnë subjektet e marrëdhënieve detyrimore dhe të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar respektivisht duhet të ekzistoj shkaktuesi i dëmit dhe i dëmtuari, të ekzistojë fakti dëmtues, nga rrjedh dëmi, të ekzistoj dem i shkaktuar, të ekzistoj lidhja shkakësore ndërmjet faktit dëmtues dhe demit të shkaktuar si dhe të ekzistoj kundërligjshmëria e veprimit, përkatësisht e mosveprimit nga është shkaktuar dëmi, të cilat kushte duhen të plotësohen në mënyrë komulatiuve. Në rastin konkret me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, është vërtetuar fakti vendimtar se deri te dëmi i shkaktuar ka ardhur si pasojë e shkaktimit të zjarrit nga resiveri e cila pajisje është në

pronësi të paditurës si dhe gjykata e shkallës së parë drejt i ka zbatuar edhe dispozitat tjera materiale të parapara me nenin 172, 173 dhe nenin 174 të LMD-së.

Në një gjendje të tillë të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës pranon si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë lidhur me pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë së paditësit, pasi që aktgjykimet e këtyre gjykatave në këtë çështje kontestimore nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, në të cilat në kuptim të nenit 215 të LPK, gjykata e revizionit kujdeset sipas detyrës zyrtare. Së këndejmi u refuzuan si të pabazuara pretendimet e revizionit për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n, të LPK.

Kjo gjykatë e shqyrtoi edhe pretendimin e të paditurës, se gjykata e shkallës së dytë nuk e ka shqyrtuar faktin se me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, nuk është sqaruar lidhur me vendimet e marra dhe faktet mbi të cilat është provuar, Gjykata Supreme me vështrim në shkresat e lëndës gjeti se në aktgjykimin e shkallës së parë dispozitivi është i rregullt dhe në përputhje të plotë me arsyetimin e dhënë, ndërsa aktgjykimi i shkallës së dytë përmban arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha pretendimet e paraqitura në ankesë, përfshirë edhe shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse lidhur me mënyrën e vendosjes meritore të çështjes kontestuese. Në këtë kontekst, janë dhënë arsye bindëse me të cilat janë treguar faktet thelbësore të cilat janë marrë në vlerësim me rastin e vendosjes meritore, janë dhënë arsye për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e shfrytëzuara dhe për mënyrën e vlerësimit të provave të shfrytëzuara. Në logjikën e njëjtë është edhe aktgjykimi i shkallës së dytë në të cilin paraqiten arsyet për konfirmimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë ka përmbajtje koherente në rrjedhë logjike dhe juridike duke i arsyetuar të gjitha pretendimet ankimore dhe shkeljet që vlerësohen sipas detyrës zyrtare, lidhur me vlerësimin se aktgjykimi i shkallës së parë është i ligjshëm.

Me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë janë konsumuar të gjitha pretendimet ankimore përmes vlerësimit objektiv dhe në përputhje me dispozita ligjore, gjykata e shkallës së dytë ka vepruar në pajtim të plotë me nenin 204-të LPK-së, i cili parasheh se " Në arsyetimin e aktgjykimit, gjykata e shkallës së dytë duhet t'i vlerësojë thëniet në ankesë që kanë qenë të rëndësisë vendimtare për dhënien e vendimit të saj", prandaj Gjykata Supreme e Kosovës e vlerëson të paqëndrueshëm pretendimin për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore lidhur me strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimeve të instancave më të ulëta.

Pretendimet e revizionit për zbatim të gabuar të së drejtës materiale nuk u pranuan si të bazuara nga ana e Gjykatës Supreme, pasi që gjykata e shkallës së parë dhe e dytë duke e vlerësuar

të njëjtin pretendim të paditësit të paraqitur edhe pranë këtyre gjykatave, kanë dhënë arsyetim të plotë, të qartë dhe të njëjtat arsye janë të pranueshme edhe për gjykatën e revizionit.

Kontestuese në mes ndërgjyqësve ishin faktet se si është shkaktua zjarri dhe për këtë të dy gjykatat me të drejtë kanë bazuar vendimmarrjen e vet në konstatuimet e ekspertizave të cilët e pohojnë faktin se shkaktarë i zjarrit është resiveri me defekt i instaluar nga e paditura. Me vështrim në shkresa të lëndës del se gjykata e shkallës së parë ka angazhuar ekspertin Y. Z. i cili ka konstatuar se shkaktari i zjarrit është resiveri, si pasojë e mos barazimit të potencialit elektrik mes rrjetit kabllor dhe paisjeve tek klienti. Pas vërejtjeve të paraqitura nga ana e të paditurës, është caktuar eksperti tjetër Xh. S., i cili në ekspertizën e datës 09.10.2018, ka konstatuar se shpërthimi i zjarrit ka ndodhur më datë 31.05.2009 në ora 17:10, në asnjë rrethanë, faktori njeri nuk mund të jetë i implikuar në shkaktimin e dëmit gjatë shpërthimit të zjarrit.

Në seancës e administrimit të provave e më datën 11.11.2020 përfaqësuesi i autorizuari i të paditurës ka kërkuar sqarime shtesë nga eksperti Xh. S. i cili ka marrë pjesë në seancën e shqyrtimit më datën 17.12.2020 duke dhënë sqarimet shtesë të kërkuara nga e paditura. Edhe për gjykatën e revizionit konstatimi i eksperti se "meqenëse resiveri kyçet-furnizohet me tension 220 (V), ndërsa në dalje kemi vetëm sinjal digjital, pra nuk kemi kurrfarë ngarkese, atëherë gjasa teorike për ngrohje të tepërt ose për vetëndezje të resiverit nuk ekziston. Pra në rastin konkret pajisja elektrike – resiveri ka qenë me defekte teknike, ku ka dhënë mendimin se zjarri ka filluar mu nga resiveri.

Në këtë kuptim nuk janë pranuar pretendimet e revizionit të paditurës për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ngase sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme për sa i përket kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë kanë aplikuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale duke aplikuar nenin 136, par.1, të LMD-së lidhur me dëmin, dhe nenin 169 të LMD-së, lidhur me rivendosjen e gjendjes së mëparshme. Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës e refuzon si të pa bazuar pretendimin e të paditurës për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe për zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion nga paditësit, nuk janë vlerësuar pasi që sipas dispozitës së nenit 214 paragraf 2, të LPK-së, përcaktohet se: “revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike”.

Nga sa u tha më sipër e me zbatimin e nenit 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2019:208262
Datë: 13.01.2025
Numri i dokumentit: 06702653

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.573/2024, datë 13.01.2025

Kryetari i kolegjit,

Beshir Islami